

RELACION TEKNIK (PROJEKT ME PERSHKRIM)

KONTRATA NR. 4 : “MIRËMBAJTJE RUTINE ME PERFORMANCË RRUGA LEVAN – MIFOL (E VJETRA) + RRUGA VLORE – MIFOL (E VJETRA) + RRUGA RRETHQARKULLIM BABICE – PESHKEPI + RRUGA PESHKEPI – SELENICE + RRUGA E AEROPORTIT TE VLORES 47,2 KM”

1. Qëllimi i Shërbimeve që do kryhen

Shërbimet që do mundësohen përfshijnë gjithë veprimtaritë, fizike dhe të tjera, që duhet të kryhen, sipas përputhshmërisë së tyre me Nivelet e Shërbimit dhe kriterin e caktuar të realizimit të tyre të performancës, apo me çdo kërkesë tjetër.

Në vecanti, ato përfshijnë detyrat menaxheriale dhe punimet fizike që lidhen me asetet dhe zërat që lidhen me rrugën:

- Asfaltimet
- Bankinat
- Sinjalistika dhe furnizimi pajisjet për sigurinë rrugorë
- Strukturat e drenazhimit
- Kontrolli i vegjetacionit
- Skarpatat (gërmimet dhe bankinat)
- Veprat e artit
- Menaxhimi i trafikut
- Grumbullimi i dherave
- Pastrimi i dëborës (nqs ka mirëmbajtje dimërore)

Shërbimet që kërkon Mirëmbajtja e një rruge klasifikohen në:

2. Punimet Rehabilituese/periodike, në formën e sasisë së një vlere tavan, ndërsa tregohen sasisë e punimeve të matëshme që do kryhen në mënyrë që rruga të arrijë Standardet e asaj performancë.
3. Shërbimet e Mirëmbajtjes Rutinë në formën e sasisë së shprehur në një vlerë tavan mujore (kjo do jetë një sasi mujore e aplikueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes se kontratës se shprehur në çmim për kilometër për secilin muaj e shumëzuar me gjatësinë e rrugës dhe kohëzgjatjen e shërbimeve);
4. Punimet Emergjente në formën e një preventivi tradicional.

Funksionet kryesore të bazave të mirëmbajtjes në përgjithësi, duhet të jenë si më poshtë:

1. Mbikëqyrja e segmentit/seksionit rrugor në periudha të caktuara sipas niveleve të shërbimit
2. Kontrolli i të dhënave të trafikut për këtë segment
3. Vëzhgimi i faktorëve meteorologjikë
4. Ndihma e parë në rast aksidenti (në lidhje me elementët e rrugës dhe trafikut)
5. Mirëmbajtje në kushtet e dëshiruara të shtresave rrugore
6. Mirëmbajtja e hapësirave të parkimit, shërbimit, shenjave rrugore, sistemeve të ndriçimit, sinjalizimit të ardhshëm e telekomunikacionit.
7. Riparime dhe rindërtim pas aksidenteve rrugorë
8. Riparime dhe rindërtim pas fatkeqësive natyrore

9. Operacionet e pastrimit të drenazheve, tombinove dhe objekteve të tjera që lidhen me largimin e ujrave nga sipërfaqja e rrugës

10. Të gjithë operacionet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e :

- shenjave rrugore, pajisjeve të sigurise (gardhe, parapet) sistemi i ndricimit.
- riparimi lokal i dëmtimeve të trotuarit
- kujdesi për bimesinë
- aktiviteti në dimer për largimin e dëborës dhe akullit.

Punimet e mirëmbajtjes në kushtet dimërore, përfshijnë:

1. Punime paraprake para fillimit të kushteve të dimrit
2. Organizimi i vendodhjeve të depozitimit të materialeve
3. Masat mbrojtëse për borën, akullin, grumbujt e borës dhe ortekët
4. Pastrimi i dëborës nga karrexhata e autostrades dhe sinjalet e komunikacionit dhe shenjat
5. Shenjimi i anëve të karrexhatës
6. Sigurimi i funksionimit të drenazhimit nga karrexhata
7. Heqjen e automjeteve nga rruga
8. Instalimi i sinjaleve të vecanta të komunikacionit në rastet e rregjimit të trafikut të veçantë të mbylljes së rrugës.
9. Informimi i vazhdueshëm i publikut për gjendjen e rrugës dhe rrjedhën e trafikut.

5. Akset rrugore që mbulon kontrata:

Nr. Rrugës	Nr. Rendor	Emërtimi i Rrugëve	Kategoria e rrugës	Gjatësia totale (km)	Gjerësia (m)
SH 8	1	Levan – Mifol (e vjetra)	C	4.7	6
SH 8	2	Vlore – Mifol (e vjetra)	C	18.3	6
SH 76	3	Rrethqarkullimi Babice – Peshkepi	C	6.8	6
SH 77	4	Peshkepi – Selenice	C	14.7	5
W72	5	Rruga e Aeroportit të Vlores	C	2.7	7
SHUMA E KONTRATES:				47.2	

6. Kusht i veçantë

Për çdo rast, nga kontrata do të zbriten segmente të saj nqs do të përfshihen në investim (rikonstrukcion) apo projekte të tjera të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

7. Sinjalistika dhe siguria rrugore

Mirëmbajtja e sinjalistikës dhe siguria rrugore (barrierat) do të fokusohet tek riparimi dhe rifreskimi e asaj ekzistuese.

8. Përshkrimi i zonës ku ndodhen rruget dhe gjendja teknike.

I – Aksi rrugor Levan – Mifol (e vjetra) 4.7 km

Ky aks rrugor është pjesë e segmentit rrugor që lidh Fierin me Vlorën nga rruga e vjetër. Është një aks shumë i rëndësishëm nga pikpamja social – ekonomike pasi kalon në shumë qendra të banuara, i shërben një komuniteti të madh banorësh dhe shumë bizneseve të karakterit bujqësor, blegtoral dhe agroturistik.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Rruga është duke u rikonstruktuar në të gjithë gjatësinë e saj me anën e një investimi nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Theksojmë se gjatë vitit 2025 dhe pjesërisht gjatë vitit 2026 rruga do të jetë në garanci defektesh, në varesi nga dita e kolaudimit. Prandaj mirëmbajtja rutine është planifikuar një vit mirëmbajtje e reduktuar dhe tre vite mirëmbajtje rutine e plote.

Shtresat asfaltike janë në gjendje të mirë, pasi aksi është rikonstruktuar dhe gjendja aktuale e tij paraqitet pa probleme.

Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për ndërhyrje vazhdimisht.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për përmirësime, po kështu dhe sinjalistikën vertikale të bëhen zëvendësime të pjesshme dhe rifreskime.


Rruga është në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore, por kur del lumi Vjosë ka përmytje. Kujdes i veçantë duhet të tregohet me Uren e Mifolit. Ura e Mifolit është një urë automobilistike dhe hekurudhore që ndodhet mbi lumen Vjosë. Ka një gjatësi 264 m me 13 hapësira drite. Gjerësia e urës automobilistike është 7 m + 2 trotuare nga 0.9 m. Është urë prej betoni të armuar me trape të parapregatitur në formë "T" dhe me ballna dhe pila prej betonarmeje mbështetur në pilota. Nga pikpamja konstruktive dhe e aftësisë mbajtëse ura nuk paraqet probleme serioze. Prej shumë vitesh janë evidentuar probleme amortizimi në urë siç janë zbulim dhe korrodime të armaturores së hekurit në elemente të vecanta b/a të urës siç janë traret etj, prandaj të gjithë elementet e urës duhet të inspektohen rregullisht dhe të bëhen riparimet në kohë.

Nga pikpamja e Mirëmbajtjes Dimërore rruga nuk paraqet probleme shqetësuese. Reshjet e deborës janë të rralla. Formimi i ngricave dhe akullit në stinën e dimrit është evident në rastet e temperaturave të ulëta dhe duhet të menaxhohet.

Rruga është në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Kordinat gjeografike të fillimit: 40°40'18.1", 19°29'10.9"

Kordinat gjeografike të mbarimit : 40°38'05.0", 19°27'41.9"



II - Aksi rrugor Vlore – Mifol (e vjetra) 18.3 km

Ky aks rrugor është pjesë e segmentit rrugor që lidh Fierin me Vlorën nga aksi vjetër. Eshte nje aks shume i rendesishem nga pikpamja social – ekonomike pasi kalon ne shume qendra te banuara, i sherben nje komuniteti te madh banoresh dhe shume bizneseve te karakterit bujqesor, blegtoral dhe agroturistik.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Rruga eshte rikonstruktuar ne te gjithe gjatesine e saj me anen e nje investimi nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Theksojme se gjate vitit 2025 dhe pjeserisht gjate vitit 2026 rruga do te jete ne garanci difektesh, ne varesi nga dita e kolaudimit. Prandaj mirembajtja rutine eshte planifikuar nje vit mirembajtje e reduktuar dhe tre vite mirembajtje rutine e plote.

Shtresat asfaltike janë në gjendje të mirë, pasi aksi është rikonstruktuar dhe gjendja aktuale e tij paraqitet pa probleme.

Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për ndërhyrje vazhdimisht.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për permiresime, po kështu dhe sinjalistikën vertikale të bëhen zëvendësime të pjesshme dhe rifreskime.


Rruga është në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore, por kur del lumi Vjosë ka përmbytje. Kujdes i vecante duhet te tregohet me Uren e Mifolit. Ura e Mifolit është një urë automobilistike dhe hekurudhore që ndodhet mbi lumen Vjosë. Ka një gjatësi 264 m me 13 hapësira drite. Gjersia e urës automobilistike është 7 m + 2 trotuare nga 0.9 m. Është urë prej betoni të armuar me trape të parapregatitur në formë "T" dhe me ballna dhe pila prej betonarmeje mbështetur në pilota. Nga pikpamja konstruktive dhe e aftësisë mbajtëse ura nuk paraqet probleme serioze. Prej shumë vitesh janë evidentuar probleme amortizimi në urë siç janë zbulim dhe korrodime të armatures së hekurit në elemente të vecanta b/a të urës siç janë traret etj, prandaj të gjithë elementet e urës duhet të inspektohen rregullisht dhe të bëhen riparimet në kohe.

Nga pikpamja e Mirëmbajtjes Dimërore rruga nuk paraqet probleme shqetësuese. Reshjet e deboret janë të rralla. Formimi i ngricave dhe akullit në stinën e dimrit është evident në rastet e temperaturave të ulëta dhe duhet të menaxhohet.

Rruga është në terren kodrinor – fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Kordinat gjeografike të fillimit: 40°29'27.3", 19°28'49.1"

Kordinat gjeografike të mbarimit : 40°38'05.0", 19°27'41.9"



III- Aksi rrugor Rrethqarkullimi Babice – Peshkepi 6.8 km

Aksi rrugor Rrethqarkullimi Babice – Peshkepi eshte nje aks i rendesishem kombetar. Ai lidh Bypassin e Vlores me rrugen e Lumit te Vlores dhe me krahinat e Selenices te Vllahines etj. Nga pikpamja social – ekonomike paraqitet me rendesi te vecante, pasi i sherben nje komuniteti te madh banoresh. Ai lidh ne nje numer te madh qendrash te banuara ku ka zhvillim te madh te aktivitetit bujqesor e blegtoral si dhe te agroturizmit. Edhe nga pikpamja turistike eshte nje aks i rendesishem.

Rruga shtrihet ne nje terren fushor me parametra planimetrike te favorshme. Edhe parametrat altimetrike jane te mira. Ky segment rrugor eshte rikonstruktuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit para rreth 6 vjetesh.

Shtresat asfaltike jane ne gjendje pergjithesisht te mire , ka nevojte per riparime te vogla.

Kanalet anesore dhe tombinot dhe veprat e artit kanë nevojë për mirembajtje vazhdimisht.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për permiresime, zëvendësime të pjesshme dhe rifreskime.

Rruga është në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Nga pikpamja e Mirembajtjes Dimerore rruga nuk paraqet probleme te medha. Reshjet e debores jane te rralla.


Formimi i ngricave dhe akullit ne stinen e dimrit eshte evident ne rastet e temperaturave te uleta dhe duhet te menaxhohet.

Rruga është në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.

Koordinat gjeografike te fillimit: 40°28'19.5", 19°31'16.7"

Koordinat gjeografike te mbarimit : 40°28'16.4", 19°34'57.7"



IV- Aksi rrugor Peshkepi – Selenice 14.7 km

Ky segment është vazhdim i segmentit rrugor kryqëzim Rr/Babice – Peshkëpi dhe lidh Bashkinë Vlorë me Bashkinë Selenicë dhe zonën naftënxjerrëse Vllahinë.

Rruga shtrihet ne nje terren fushor me parametra planimetrike ne pergjithesi te favorshme me pak kthesa te forta dhe me gjeresi relativisht te vogel. Parametrat altimetrike te rruges jane te mira.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Rruga eshte rikonstruktuar vitet e fundit ne te gjithë gjatesine e saj me anen e nje investimi nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Theksojme se gjate vitit 2024 rruga do te jete ne garanci difektesh.

Shtresat asfaltike janë në gjendje relativisht të mirë, pasi aksi eshte rikonstruktuar por gjendja aktuale e tyre paraqitet me probleme ne disa zona ku jane realizuar nderhyrje brenda garancise se difekteve.

Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për ndërhyrje vazhdimisht.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për permiresime, zëvendësime të pjesshme dhe rifreskime.

Nga pikpamja e Mirembajtjes Dimerore rruga nuk paraqet probleme te medha. Reshjet e debores jane te rralla.

Formimi i ngricave dhe akullit ne stinen e dimrit eshte evident ne rastet e temperaturave te uleta dhe duhet te menaxhohet.

Rruga është në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Kordinat gjeografike te fillimit: 40°28'16.4", 19°34'57.7"

Kordinat gjeografike te mbarimit : 40°32'14.7", 19°38'05.9"



V- Rruga e Aeroportit te Vlores 2.7 km

Ky është një aks rrugor i ri bregdetar që lidh Aeroportin e Vlores me Autostraden A2, është një rrugë mjaft e rëndësishme që i shërben shumë turizmit dhe transportit ajror në përgjithësi. Rruga shtrihet në një terren fushor me parametra planimetrike të favorshme. Edhe parametrat altimetrike janë të mira.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Rruga është duke u ndërtuar në të gjithë gjatësinë e saj me anën e një investimi të realizuar vitin e fundit.

Thëksojmë se gjatë vitit 2025 dhe gjatë vitit 2026 rruga do të jetë në garanci të defektshme prandaj mirëmbajtja rutine është planifikuar dy vite e plote dhe dy vite e reduktuar.

Shtresat asfaltike janë në gjendje të mirë, pasi aksi është ndërtuar i ri dhe gjendja aktuale e tij paraqitet pa probleme.

Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për ndërhyrje e mirëmbajtje vazhdimisht.

Sinjalistika dhe siguria rrugore pritet të ketë nevojë për përmirësime, zëvendësime të pjesshme dhe rifreskime.


Nga pikpamja e Mirëmbajtjes Dimerore rruga nuk paraqet probleme të mëdha. Reshjet e debore janë të rralla.

Formimi i ngricave dhe akullit në stinën e dimrit është evident në rastet e temperaturave të ulëta dhe duhet të menaxhohet.

Rruga është në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Kordinat gjeografike të fillimit: 40°36'53.6", 19°28'07.1"

Kordinat gjeografike të mbarimit : 40°36'05.4", 19°26'33.1"



GRUPI PUNES